

Nr Prot 11 Stages/pe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Nr. 2948 Prot.
13

Tiranë, më 04.05.2022

Lënda: Dërgohet Vendimi i Bordit të AMF-së dhe Licenca.

SHOQËRISË “REGJISTRI SHQIPTAR I TITUJVE ALREG” SH.A.
Rruga “Nikolla Tupe”, Nr. 1, Kati 3, Ap. 3, Tiranë.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ju ve në dijeni se me Vendimin e Bordit Nr. 91, datë 28.04.2022, ka miratuar përshtatshmërinë e shoqërisë “Regjistri Shqiptar i Titujve ALREG” sh.a. me kërkesat e Ligjit 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, për të vepruar si Regjistrar dhe Depozitar Qendror i Titujve dhe rregulloren operationale të ndryshuar të shoqërisë “Regjistri Shqiptar i Titujve ALREG”, depozituar me shkresën tuaj nr. 33 Prot., datë 18.11.2021 protokolluar në Autoritet me nr. 2948 Prot., datë 19.11.2021.

Bashkëlidhur do të gjeni Vendimin e Bordit, Licencën dhe Aneksin e Licencës së shoqërisë “Regjistri Shqiptar i Titujve ALREG” sh.a.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

LICENCË

PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË REGJISTRARIT / DEPOZITARIT QENDROR TË TITUJVE

Nr. 1, datë 28.04.2022

Autoriteti i Mbiqëqyrjes Financiare, në bazë dhe për zbatim të nenit 13, të Ligjit Nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbiqëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, të Ligjit Nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit” dhe Vendimit Nr. 91, datë 28.04.2022, të Bordit të AMF-së, i jep shoqërisë,

“REGJISTRI SHQIPTAR I TITUJVE ALREG” SH.A.

Licencën për të vepruar si Regjistrar dhe Depozitar Qendror i Titujve në Republikën e Shqipërisë.

Licenca i lejon shoqërisë “Regjistri Shqiptar i Titujve, ALREG” sh.a., të kryejë shërbimet Regjistrarit dhe Depozitarit Qendror të Titujve të përshkruara në Aneksin bashkëlidhur.

Licenca është e pakufizuar në kohë, e patransferueshme dhe e pajetërsueshme.

Kjo Licencë zëvendëson Licencën Nr. 2/1, datë 19.12.2019 lëshuar nga AMF.

ERVIN METE

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Datë 28.04.2022

ANEKS

LICENCA Nr. 1

Shoqëria “Regjistri Shqiptar i Titujve ALREG” sh.a., në bazë dhe për zbatim të nenit 13, të Ligjit Nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, të ndryshuar, të Ligjit Nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, dhe Vendimit Nr. 91, datë 28.04.2022 të Bordit të AMF-së, licençohet për të vepruar si Regjistrar dhe Depozitar Qendror i Titujve në Republikën e Shqipërisë, si më poshtë:

Shërbime Kryesore

1. Regjistrimi fillestar i titujve në një sistem regjistrimi (“Shërbimi i Regjistrimit Fillestar”).
2. Ofrimi dhe mbajtja e llogarive të titujve (“Shërbimi Qendror i Mirëmbajtjes së Llogarive”).
3. Operimi i sistemit të shlyerjes së titujve (“Shërbimi i Shlyerjes”).

Shërbime ndihmëse jobankare

1. Shërbime të lidhura me sistemin e shlyerjes
2. Shërbime të lidhura me shërbimet e regjistrimit fillestar dhe të mirëmbajtjes qendrore të llogarive
3. Krijimi i ndërlidhjeve të depozitarit qendror të titujve, ofrimi, mirëmbajtja ose operimi i llogarive të titujve për shërbimin e shlyerjes, administrimin e kolateralit dhe shërbime të tjera ndihmëse.
4. Shërbime të tjera.

ERVIN METE

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV



Listimi i detajuar i shërbimeve ndihmëse jobankare është si më poshtë:

1. Shërbime të lidhura me sistemin e shlyerjes, si:

- i. organizimi i një mekanizmi të huadhënies së titujve, si agjent midis pjesëmarrësve të sistemit të shlyerjes së titujve;
- ii. ofrimi i shërbimeve të administrimit të kolateralit, si agjent për pjesëmarrësit në sistemin e shlyerjes së titujve;
- iii. koordinimi i pagesave, transmetimi i urdhrave, konfirmimi i tregtimit, verifikimi i tregtimit;

2. Shërbime të lidhura me shërbimet e regjistrimit fillestar dhe të mirëmbajtjes qendrore të llogarive, si:

- i. shërbimet që lidhen me mbajtjen e regjistrave të aksionarëve;
- ii. ofrimi i asistencës për trajtimin e procedurave të shoqërisë tregtare, përfshirë ato tatimore, asamblatë e përgjithshme dhe shërbimet e informacionit;
- iii. shërbimet lidhur me emetimet e reja, përfshirë caktimin dhe administrimin e kodeve ndërkombëtare të identifikimit të titujve ISIN dhe kodeve të tjera të ngjashme;
- iv. transmetimi dhe përpunimi i urdhrave, mbledhja dhe përpunimi i tarifave dhe raportimet lidhur me to.

3. Krijimi i ndërlidhjeve të depozitarit qendror të titujve, ofrimi, mirëmbajtja ose operimi i llogarive të titujve për shërbimin e shlyerjes, administrimin e kolateralit dhe shërbime të tjera ndihmëse.

4. Çdo shërbim tjetër, si:

- a) ofrimi i shërbimeve të përgjithshme të administrimit të kolateralit si agjent;
- b) ofrimi i shërbimit të raportimit rregullator;
- c) ofrimi i informacionit, të dhënave dhe statistikave zyraive të tregut/censit ose subjekteve të tjera shtetërore ose ndërqeveritare;
- ç) ofrimi i shërbimeve të teknologjisë së informacionit.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 91, datë 28.04.2022

MBI

**MIRATIMIN E PËRSHTATSHMËRISË SË SHOQËRISË “REGJISTRI SHQIPTAR I
TITUJVE ALREG” SH.A. ME KËRKESAT E LIGJIT NR.62/2020 “PËR TREGJET E
KAPITALIT” SI DHE MIRATIMIN E RREGULLORES OPERACIONALE TË
NDRYSHUAR**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, neneve 211, 212, 224, 226 dhe 377, pika 1 të Ligjit 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

KONSTATOI SE:

Ligji nr.62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, në nenin 377, pika 1, parashikon se: “Të gjitha subjektet e licencuara në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”, vijojnë veprimtarinë për të cilën janë licencuar, me kusht që brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të përshtaten me kërkesat e këtij ligji”.

Për të vijuar veprimtarinë për të cilën është licencuar, shoqëria “Regjistri Shqiptar i Titujve ALREG” sh.a., duhet të përshtatet me kërkesat dhe kushtet e Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”.

Shoqëria “Regjistri Shqiptar i Titujve ALREG” sh.a., aktualisht mban licencën nr. 2/1, datë 19.12.2019 “Për ushtrimin e veprimtarisë së organizimit dhe administrimit të të dhënave për titujt si dhe të klerimit dhe shlyerjes së tyre”, pas zgjerimit të licencës nr. 2, datë 31.01.2019 për ushtrimin e veprimtarisë së organizimit dhe administrimit të të dhënave për titujt.

Gjithashtu, shoqëria mban licencën nr. 2, datë 1.11.2019 nga Banka e Shqipërisë si “Operator i sistemit për shlyerjen e titujve”, në zbatim të Ligjit nr. 133/2013 datë 29.04.2013 “Për sistemin e pagesave” dhe Rregullores nr. 26 datë 29.03.2019 të BSH “Për licencimin, rregullimin dhe mbikëqyrjen e operatorëve të sistemeve për shlyerjen e titujve”.

Licenca që mban ALREG nga pikëpamja e veprimtarive të lejuara është e njëjtë me shërbimet që kryen Regjistri, si dhe Depozitari Qendror i Titujve, sipas parashikimeve të Ligjit nr. 62/2020 “Për tregjet e kapitalit”.

Për efekt të përshtatshmërisë me kërkesat e Ligjit nr. 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, shoqëria “Regjistri Shqiptar i Titujve ALREG” sh.a ka rishikuar statutin, rregulloren operacionale dhe procedurat e saj.

Për sa më sipër, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e përshtatshmërisë së shoqërisë “Regjistri Shqiptar i Titujve ALREG” sh.a. sipas kërkesave të Ligjit 62/2020 “Për Tregjet e Kapitalit”, për të vepruar si Regjistrar dhe Depozitar Qendror i Titujve për:**

Shërbimet kryesore:

- i. Regjistrimi fillestar i titujve në një sistem regjistrimi (“Shërbimi i Regjistrimit Fillestar”).**
- ii. Ofrimi dhe mbajtja e llogarive të titujve (“Shërbimi Qendror i Mirëmbajtjes së Llogarive”).**
- iii. Operimi i sistemit të shlyerjes së titujve (“Shërbimi i Shlyerjes”).**

Shërbimet ndihmëse jobankare:

A. Shërbime të lidhura me sistemin e shlyerjes, si:

- i. Organizimi i një mekanizmi të huadhënies së titujve, si agjent midis pjesëmarrësve të sistemit të shlyerjes së titujve;**
- ii. Ofrimi i shërbimeve të administrimit të kolateralit, si agjent për pjesëmarrësit në sistemin e shlyerjes së titujve;**
- iii. Koordinimi i pagesave, transmetimi i urdhrave, konfirmimi i tregtimit, verifikimi i tregtimit.**

B. Shërbime të lidhura me shërbimet e regjistrimit fillestar dhe të mirëmbajtjes qendrore të llogarive, si:

- i. Shërbimet që lidhen me mbajtjen e regjistrave të aksionarëve;**
- ii. Ofrimi i asistencës për trajtimin e procedurave të shoqërisë tregtare, përfshirë ato tatimore, asambltë e përgjithshme dhe shërbimet e informacionit;**
- iii. Shërbimet lidhur me emetimet e reja, përfshirë caktimin dhe administrimin e kodeve ndërkombëtare të identifikimit të titujve ISIN dhe kodeve të tjera të ngjashme;**
- iv. Transmetimi dhe përpunimi i urdhrave, mbledhja dhe përpunimi i tarifave dhe raportimet lidhur me to.**

C. Krijimi i ndërlidhjeve të depozitarit qendror të titujve, ofrimi, mirëmbajtja ose operimi i llogarive të titujve për shërbimin e shlyerjes, administrimin e kolateralit dhe shërbime të tjera ndihmëse.

D. Çdo shërbim tjetër, si:

- i. Ofrimi i shërbimeve të përgjithshme të administrimit të kolateralit si agjent;
 - ii. Ofrimi i shërbimit të raportimit rregullator;
 - iii. Ofrimi i informacionit, të dhënave dhe statistikave zyrave të tregut/censit ose subjekteve të tjera shtetërore ose ndërqeveritare;
 - iv. Ofrimi i shërbimeve të teknologjisë së informacionit.
2. Miratimin e rregulloreve operacionale të ndryshuar të shoqërisë “Regjistri Shqiptar i Titujve ALREG”.
 3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, si dhe Drejtoria e Licencimit për njoftimet dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Olsi ÇOKU



DREJTORI PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Ervin METE

